

Asociacioni qytetarë "BUJANOCI" në Forumin e përgjithshëm të mbajtur më _____ në _____ të Zvicrës, vendosi që të aprovoj këtë Statut



STATUTI

Asociacioni qytetarë "BUJANOCI"

(Draft i parë – 2018)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME - DEFINIMI

Neni 1

Me këtë emër Asociacioni qytetarë "BUJANOCI" e themeluar më 18.03.2018 në Zürich, definohet si Asociacioni i pavarur, jopartiak, jopolitik, joprofitabël si dhe jofetar i qytetarëve që jetojnë në territorin e Konfederatës Zvicërane e që janë me origjinë nga qyteti i Bujanocit te Republikë së Serbisë

Neni 2

Emri i plotë i Asociacionit është: Asociacioni qytetarë "BUJANOCI"

Neni 3

Asociacioni qytetarë BUJANOCI, me seli në
Floraweg 7
7310 Bad Ragaz

Neni 4

Vula e Asociacionit ka formë rrethi, në të janë të shkruara:

1. Emri i plotë Asociacioni qytetarë "BUJANOCI"
2. Tri gjuhë: Shqipe, Gjermane, Serbe dhe Frënge
3. Viti i themelimit 2018

Simboli ose Logo-ja ka formën e dy njerëzve të bashkuar dhe të integruar ne Konfederatën Zvicëriane që kanë prejardhje nga qyteti i Bujanocit.

Ngjyra e kuqe dominuese simbolizon shtetin Zvicërian dhe atë Shqiptar.

Neni 5

Asociacioni ka karakter social, humanitar, organizues dhe bamirës.

Neni 6

Selia e Asociacionit ndodhet ne Konfederatën Zvicëriane

Neni 7

E drejta juridike e Asociacionit është e bazuar dhe është në përputhje me ligjet e shtetit Zvicërian, duke respektuar të drejtat dhe obligimet që dalin nga ligjet Zvicëriane.

II. QËLLIMET DHE DETYRAT

Neni 7

7.1 Asociacioni qytetarë Bujanoci, ka per qëllim të ndihmoj integrimin e anëtarëve të Asociacionit në shoqërinë Zvicëriane, përmes aktiviteteve kulturore, sportive, humanitare, arsimore etj. në përputhje me Statusin e Asociacionit.

7.2 Ndërtimin dhe përparimin e lidhjeve miqësore ndërmjet bashkëqytetarëve, dhe qytetarëve Zvicërian, pa marr parasysht përkatësinë e tyre nacionale apo fetare.

7.3 Përkujdesje në ruajtjen dhe afirmimin e gjuhës shqipe dhe vlerave kombëtare.

7.4 Kordinimi i aktiviteteve dhe bashkëpunimi me shoqatat, organizatat si dhe asociacionet tjera në Zvicër dhe jashtë saj, që kanë qëllime të njëjta dhe janë në përputhje me Statutin e Asociacionit.

7.5 Bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe me institucionet shtetërore në Zvicër, Kosovë, Serbi dhe në gjithë botën me qëllim të promovimit të

tolerancës ndëretnike, të bashkëpunimit dhe realizimit të aktiviteteve arsimore, shkencore, humanitare, kulturore dhe sportive.

7.6 Ndhmon familjet në varfëri, jetimët si dhe personat me aftësi të kufizuara në realizimin e dëshirave dhe më gjërë.

7.7 Ndhmon projektet që realizohen në qytetin e Bujanocit me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës në qytet dhe rrethinë.

III. STRUKTURA E ASOCIACIONIT

Neni 8

8.1 Asociacioni përbëhet nga: Bordi i Asociacionit (shihe Nenin 27)

8.2 Çdo anëtar i Bordit, i këshillit mbikqyrës apo të grupeve punuese i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë vullnetare

Neni 9

9.1 Anëtar aktiv mund të bëhen të gjithë ata persona që janë me origjinë nga qyteti i Bujanocit, ndërsa anëtar pasiv janë të tjerët që paguajn antarësin dhe mbështesin qëllimet e Asociacionit.

9.2 Asociacioni nuk merr përsiper asnjë obligim ndaj anëtarëve pasiv dhe nuk shpërndanë të mira materiale për anëtarët e asociacionit, përveq në rastet e veçanta kur veçimi i tillë është në baza të arsyeshme

Neni 10

Anëtar i Asociacionit mund të bëhet:

10.1 Çdo qytetar i moshës madhore, i cili pranon parimet themelore dhe detyrat programore të Asociacionit.

10.2 Çdo qytetar pa dallim të përkatësisë kombëtare dhe fetare.

10.3 Asociacioni mund të pranoj/nominoj anëtar nderi ndonjë personalitet të shquar nga sfera kulturore, shkencore ose ndonjë personalitet i cili ka dhënë kontribut të veçantë në funksion të qëllimeve të Asociacionit.

Neni 11

11.1 Çdo anëtar i Asociacionit është i obliguar të paguaj antarësin vjetore në mënyrë të rregullt.

11.2 Pagesa bëhet në fillim të çdo viti kalendarik.

Neni 12

Dorëheqja nga Asociacioni duhet t`i adresohet Bordit me shkrim. Me dorëheqjen nga Asociacioni, fshihen të gjitha të drejtat në Thesarin e Asociacionit.

Neni 13

Kur nje anëtar dëmton interesin apo imazhin e krijuar të Asociacionit, ai mund të largohet me vendim të Bordit, nëse Bordi e sheh të arësyeshem këtë largim. Për largimin e një anëtari nga Shoqata, Bordi nuk është i obliguar t`i arsyetohet të larguarit.

IV. TË DREJTAT, OBLIGIMET DHE HUMBJET E ANËTARVE

Neni 14

Të drejtat e anëtarit:

- 14.1 Çdo anëtar është i detyruar të respektoj Statutin dhe vendimet në të mirë të Asociacionit.
- 14.2 Çdo anëtar i Asociacionit ka të drejtën e fjalës dhe shprehjes së lirë të mendimit.
- 14.3 Çdo anëtar ka të drejtën e votës.
- 14.4 Çdo anëtar ka të drejtë të propozoj ndonjë ide te caktuar në të mirë të Asociacionit.
- 14.5 Çdo anëtar i Asociacionit ka të drejtë të zgjedh ose të zgjidhet në organet e saja drejtuese.
- 14.6 Çdo anëtar ka të drejtë të jetë bartës i aktiviteteve të ndryshme të Asociacionit.
- 14.7 Çdo anëtar ka të drejtë qasjeje në arkivin e Asociacionit për ta verifikuar auditimin periodik.

Neni 15

Obligimet e anëtarit:

- 15.1 Çdo anëtar i Asociacionit është i obliguar të mos e keqpërdor emrin e saj dhe cilësinë e anëtarit për bindjet dhe aktivitetet e tij, që nuk kanë të bëjnë me qëllimet e Asociacionit.
- 15.2 Çdo anëtar është i obliguar të paguaj anëtarësinë vjetore ne vlerë prej 100.00 CHF në vit, e cila është e caktuar nga Forumi përgjithshëm.
- 15.3 Çdo anëtar duhet të respektoj programin e Asociacionit dhe të kontribuoj në realizimin e tij në rast të marrjes së ndonjë përgjegjësie.

Neni 16

Humbja e cilësisë së anëtarit te Bordit:

16.1 Në rast të largimit vullnetar nga Asociacioni, anëtari duhet të kërkoj dorëheqjen e tij me shkrim tek Bordi i Asociacionit.

16.2 Çdo person e humb cilësinë e anëtarit nëse ai shkel obligimet që rrjedhin nga Neni 15.

16.3 Ai i cili humb cilësinë e anëtarit të Asociacionit, nuk gëzon të drejtën e ndonjë kompensimi material.

V. ORGANIZIMI DHE ORGANET

Neni 17

Organet e Asociacionit janë:

- Forumi i përgjithshëm
- Bordi
- Këshilli mbikqyrës
- Grupet punuese

Neni 18

Forumit të përgjithshëm, si Organ më i lartë i Asociacionit zakonisht takohet në çerekun e parë të vitit.

Neni 19

Forumit të përgjithshëm i takojnë këto obligime:

- Verifikimi i Protokollit nga takimi i përgjithshëm i fundit.
- Dëgjimin e Raportit vjetor lidhur me aktivitetet e Asociacionit.
- Ndryshimplotësimet në Bord ose në organet tjera të Asociacionit
- Aplikimet/ Kërkesat që vijnë nga Bordi, Këshilli Mbikqyrës ose nga Anëtarët.

- Revizioni i Statusit.
- Caktimi i pagesës së antarësisë si dhe pagesave speciale të veçanta.
- Zgjedhja e Bordit.
- Zgjedhja e Kryetarit.
- Zgjedhja e Këshillit mbikqyrës.
- Të ndryshme.

Neni 20

Kërkesat për diskutim të një teme të catuar në Forumin e përgjithshëm, duhet t'i dorëzohen Bordit më së paku një javë para Forumit të përgjithshëm.

Neni 21

21.1 Ftesa për Forumin e përgjithshëm duhet të bëhet publike më së paku 2-3 javë më herët, njëkohësisht edhe Temat e Forumit.

21.2 Mbledhje të jashtëzakonshme mund të thirret nga 2/3 e anëtarëve të Bordit dhe 2/3 e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës

Neni 22

Një Forum i përgjithshëm, i jashtëzakonshëm, mund të kërkohet nga 2/3 e antarëve të Bordit të Asociacionit.

Neni 23

Në Forumin e përgjithshëm, çdo anëtar ka të drejtë të votoj, të jetë i votuar dhe ka të drejtë për kërkesë për t'u zgjedhur në organet drejtues.

Neni 24

Forum i përgjithshëm merr vendime lidhur me:

24.1 Pranimin dhe miratimin e ndonjë anëtari që nuk parashihet në nenin 15

24.2 Zgjedhjen e Bordit.

24.3 Zgjedhjen e Këshillit mbikqyrës

24.4 Zgjedhjen e grupeve punues

24.5 Përcakton shumën e kontributit të anëtarëve.

24.6 Ndryshimin dhe plotësimin e statusit.

24.7 Aprovon raportet vjetore për punën e organeve të Asociacionit.

24.8 Shkarkimin eventual të Bordit.

24.9 Shpërbërjen e Asociacionit

Neni 25

Vendimet lidhur me Nenin 24. merret vetëm në rast se për të deklarohen me shkrim më shumë se 2/3 nga të gjitha instancat serioze.

Neni 26

26.1 Për kërkesat dhe zgjedhjet votohet në mënyrë të hapur, përderisa nuk është caktuar më herët për një votim të mbyllur (shumica e thjeshtë nga anëtarët e pranishëm).

26.2 Për çdo votim, vendos shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm.

26.3 Për zgjedhjen e një pozite, në votimin e parë vendos shumica absolute, në votimin e dytë shumica e thjeshtë.

Neni 27

Organet e Bordit janë:

- Kryetari
- Nënkryetari
- Sekretari
- Zv. Sekretari
- Arkëtari
- Zv. Arkëtari
- Këshilli Mbikqyrës (2x Anëtar të lirë të jashtëm dhe 2x Anëtar të lirë të mbrendshëm)

Neni 28

Bordi zgjidhet për një periudhë prej 3 (tre) vitesh me mundësi të rizgjedhjes.

Neni 29

Obligimet e Bordit janë:

29.1 Udhëheqja e përgjithshme e Asociacionit, sipas Statutit

29.2 Përfaqësia e jashtëme

29.3 Përgaditja e ligjeve (vendimeve)

29.4 Kontabiliteti

29.5 Bordi mund të ndryshohet edhe pas një viti nëse atë kërkojnë 2/3 e anëtarëve.

29.6 Në çdo mbledhje të rregullt të Forumit mund pjesërisht të ndryshohet Bordi nëse ka propozime të reja nga anëtarët.

29.7 Bordi mund të kërkoj zëvendësimin e ndonjë anëtari, nëse ndonjë anëtar mungon pa arsye tre herë me radhë në mbledhjet e Bordit ose i njëjti pengon Bordin në punën e saj.

29.8 Bordi merr vendime me konsensus të shumicës të thjeshtë në funksion të qëllimeve të Asociacionit.

29.9 Bordi përpilon në fillim të çdo viti programin vjetor të Asociacionit dhe u`a përcjell atë anëtarve të saj.

29.10 Bordi formon nga anëtarësia e gjerë grupe pune për organizimin e aktiviteteve të caktuara.

29.11 Në fund të çdo viti Bordi i raporton me shkrim online anëtarësis për veprimet dhe aktivitetet e bëra.

Neni 30

Bordi mund të takohet atëherë kur e sheh të nevojshme kryetari apo shumica asbolute e Bordit.

Neni 31

Organi i Anëtarëve të lirë përbëhet nga tre anëtar të lirë që zgjidhen nga Forumi i përgjithshëm, të cilët kanë mandat tre vjeçar dhe mund të jenë pjesë të Bordit.

Neni 32

Funksionet e secilit anëtar të Bordit :

32.1 Kryetari i Asociacionit drejton mbledhjet e Bordit dhe ato të Forumit të përgjithshëm.

32.2 Kryetari përfaqëson Asociacionin në takime dhe aktivitete të ndryshme.

32.3 Nënkryetari i ushtron të gjitha funksionet e kryetarit në mungesë të tij.

32.4 Sekretari është përgjegjës për mbajtjen e gjithë dokumentacionit të shoqatës.

32.5 Bordi është përgjegjës për arkën e shoqatës. Në fund të çdo viti e bën bilancin dhe raporton para Forumit.

32.6 Arkëtari dhe Zv. Arkëtari duhet të marr paraprakisht aprovimin me shkrim të Kryetarit dhe Sekretarit për transaksionet bankare.

32.7 Ekzekutimi i tranaksioneve bankare bëhet menjëher pas nënshkrimit te Kryetarit dhe dy anëtarëve të Bordit.

32.8 Për çdo aktivitet arkëtari bën një raport buxhetor dhe e paraqet para Bordit për miratim.

32.9 Sekretari është përgjegjës për komunikim me shkrim me anëtarët.

32.10 Anëtarët e lirë të kryesisë marrin detyra të veçanta në rast të nevojës që ka Bordi.

32.11 Grupet punuese zgjidhen nga Bordi dhe ndihmojnë kryesinë në punën e saj.

VI. ADMINISTRATA

Neni 33

Në Forumet e përgjithshme dhe takimet e Bordit duhet të mbahet një Protokollë (Procesverbal).

Neni 34

Për hyrjen ne fuqi të një vendimi, përgjegjës është Bordi.

VII. FINANCAT

Neni 35

Viti i Asociacionit për Financa përfundon në ditën e fundit të vitit.

Neni 36

Të hyrat e Asociacionit përbëhen posaçërisht nga:

36.1 Asociacioni financohet nga kontributet vjetore të anëtarëve

36.2 Pagesat vullnetare dhe dhuratat

36.3 Nga sponsorët dhe donacionet e ndryshme

36.4 Nga fondi për reklamat në webfaqen e saj

36.5 Nga aktivitetet e ndryshme

Neni 37

Destinimi i mjeteve të grumbulluara:

37.1 Asnjë aktivitet i Asociacionit nuk duhet të kalojë mundësinë financiare të arkës së Asociacionit.

37.2 Financimi i aktiviteteve organizuese janë prioritet i Asociacionit dhe financohen kryesisht nga fondi i anëtarësisë.

37.3 Çdo aktivitet financiar i cili kalon shumë prej 5'000 CHF duhet të aprovohet me konsensus të Bordit dhe Këshillit mbikqyrës

37.4 Fondi i anëtarësisë nuk guxon të bie nën 30% brenda një viti nga hyrjet vjetore.

Neni 38

Të dalurat e Asociacionit përbëhen posaçërisht nga:

- Kostot administrative

- Marketingu mediatik
- Të dalurat e Asociacionit për të cilat përcaktohen nga Forumi i përgjithshëm dhe Bordi.
- Të dalura të përcakturara nga Statuti që përmbushin detyrat dhe qëllimet e Asociacionit.

Neni 39

Hyrjet dhe daljet në xhirollogarin rrjedhëse Bankare kontrollohen nga Bordi pas përfundimit të cdo viti kalendarik.

Neni 40

Për detyrimet e Asociacionit, përgjigjet vetëm thesari i Asociacionit.

VIII. REVIZIONI

Neni 41

Ndryshimet në Statut mund të bëhen vetëm në Forumin e përgjithshëm me shumicën absolute e të pranishmëve me të drejtë vote.

Neni 42

Shpërbërja, bashkimi dhe përshtatja e synimit të Shoqatës mund të bëhet vetëm nëse:

42.1 Këtë e kërkojnë 2/3 e anëtarëve prezent në Forumin e përgjithshëm. .

42.2 Numri anëtarëve zvogëlohet nën 10 anëtar.

Neni 43

Nëse shpërbëhet shoqata, e gjithë pasuria e mbetur do të ju shpërndahet personave me aftësi të kufizuara për jetimet në qytetin e Bujanocit.

Neni 44

Ky statut hyn në fuqi në ditën e aprovimit të tij nga ana e Forumit të përgjithshëm.

Anëtarët e Bordit për mandantin një vjeçar për periudhën 2019

Kryetar:	Bujar SOPI
Nënkryetar:	Lulzim ABAZI
Sekretar:	Memet QAZIMI
Zv. Sekretar:	1. Sead SURDULLI 2. Bekim GJUMSHITI
Arkëtar:	Fisnik SHABANI
Zv. Arkëtar:	1. Mensur DESTANI 2. Arsim BEQIRI
Këshilli mbikqyrës:	1. Tefik SELMANI 2. Esat BAJRAMI 3. Ismet HASANI 4. Gani LEKA

